

## Rezoluta e Komisionerëve dhe Ombustman-ëve Evropian të së Drejtës së Informimit

Berlin, 24 shkurt 2017

Zbatimi i Ligjit të së Drejtës për Informim! Forcimi i Komisionerëve Evropian të së Drejtës së Informimit!

Shumë vende dhe rajone në Evropë kanë ligje të cilat rregullojnë të drejtën për akses në informacionet zyrtare. Komisionerët dhe Ombudsman-ët e të Drejtës së Informimit, garantojnë mbështetje dhe këshillim për qytetarët në ushtrimin e të drejtës së tyre për informim. Gjithashtu, ata nxisin zbatimin e ligjshëm të aksesit në dokumenta zyrtare nëpërmjet këshillimit dhe monitorimit të autoriteteve publike.

E drejta e aksesit në informacion mund të jetë plotësisht efektive vetëm nëse zbatimi i saj shoqërohet dhe mbështetet nga Komisionerët dhe Ombudesman-ët, si ndërmjetësit kryesor midis shtetit dhe qytetarëve.

Pjesëmarrësit në takimin Evropian të Komisionerëve dhe Ombudsman-ëve, kërkuar mbështetjen e parlamentit dhe qeverisë, për të siguruar që çdo qytetar në vendin e tij të ketë mundësi të vërë në lëvizje Autoritete mbikqyrëse të pavarura dhe t'u garantojnë këtyre të fundit mbështetje financiare të mjaftueshme ashtu si edhe burime njerëzore dhe kompetenca ligjore në përputhje me misionin e tyre. E drejta për informim dhe transparenca janë elementët kryesorë për funksionimin e shtetit ligjor dhe demokratik.

Gjithsesi, në Evropë, e drejta për informim varet edhe nga shkëmbimi i eksperiencave dhe modeleve të ngjashme, madje ajo forcohet edhe me tepër nga zhvillimi dhe forcimi i bashkëpunimit të Komisionerëve të të Drejtës për Informim, nëpërmjet projekteve në nivel ndërkombëtar.

Bashkëpunimi i Komisionerëve dhe Ombudsman-ëve për të Drejtën e Informimit duhet të jetë i përhershëm dhe të forcohet akoma më shumë.

Grupi i punës pranoi se Evropa ka nevojë për standarde të përbashkëta për të drejtën për informim, të cilat duhen udhëhequr nga komisionerët, Ombudsman-ët, parlamentet dhe qeveritë nëpërmjet dialogut konstruktiv.

Për shkak të mandateve të Ombudsman-ëve Evropian, të parlamentit Danez dhe Norvegjez, këto institucione nuk janë pjesë e kësaj deklarate.